

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 29.12.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 28.12.2023, pas shqyrtimit të Planit të Kuvendit të Komunës për vitin 2024 i përgatitur nga Grupi Punues i Formuar me Vendimin me Nr.190 të datës 07.11.2023, të paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, i shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (ç), nenin 40, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 9, të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 62, të datës 16.05.2013 mori:

V E N D I M


Për aprovimin në parim të Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Planit Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 29.12.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 28.12.2023, pas shqyrtimit të dytë të Projekt-Planit Lokal të Veprimit për mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026 në Komunën e Fushë-Kosovës, sipas vendimit për aprovimin në parim, me vendimin Nr. 148, të datës 04.07.2023, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për miratimin e Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026 në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për miratimin e Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026 në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026 në Komunën e Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh zbatimin nga institucionet komunale të programeve, punëve dhe aktiviteteve për mbrojtjen nga dhuna në familje.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Planit Lokal të Veprimit për mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026 në Komunën e Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorive të Komunës dhe Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës, Njësisë për DNJBGJ dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVËS/KOSOVO-POLJE



Datë: 29.12.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 28.12.2023, pas shqyrtimit të Kërkesës Nr. 213, të datës 15.12.2023, të paraqitur nga Shefi i Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (e), nenin 51, paragrafi 51.1, nenin 52, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 3, paragrafi 1 dhe 2, nenin 4, nenin 5, nenin 6, paragrafi 4, të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 27, shkronja (e), nenin 34, paragrafi 34.1, shkronja (a), nenin 35, nenin 37, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për ndryshimin - plotësimin e vendimit Nr. 199, të datës 31.12.2021

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.2, të vendimit Nr. 199, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke e larguar e z. Remzi Shala nga përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa prej shtatë anëtarëve dhe për caktimin e z. Laureat Gojnovci në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 199, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, në Komunën e Fushë-Kosovës dhe parasheh detyrat dhe përgjegjësitë si: shqyrtimin e politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore afatmesme buxhetore, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raportit nga Kryetari i Komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Udhëheqëses së Personelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Anëtarëve të Komitetit për Politikë e Financa, Udhëheqëses së Personelit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 29.12.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 28.12.2023, pas shqyrtimit të Kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës në kuadër të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, të paraqitur nga Shefi i Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (e), nenin 51, paragrafi 51.2, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 1 dhe 3, nenin 14, nenin 15, të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 27, shkronja (e), nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin - plotësimin e vendimit Nr. 52, të datës 07.03.2022

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1, të vendimit Nr. 52, të datës 07.03.2022 për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke e larguar z. Laureat Gojnovci nga përbërja e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale prej pesë anëtarëve dhe caktimin e z. Fidan Berisha në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 52, të datës 07.03.2022, për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në Komunën e Fushë-Kosovës dhe parasheh detyrat dhe përgjegjësitë e definuara në nenin 8, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017, për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Udhëheqëses së Personelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së FB, Anëtarëve të Komitetit për Shëndetësi e Mirëqenie
Sociale, Udhëheqëses së Personelit dhe Arkivës.**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili